



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P. nr.512/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit: G.B. nga ..., për shkak të veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.479/2016 të datës 25.06.2018, të pranuar në Gjykatë me datë 28.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 26.03.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Fikrije Sylejmani dhe të pandehurit, me datë 28.03.2019 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 15.04.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.B., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton në rrugën “...” nr..., i martuar, punon si moler, ka të kryer vetëm 4 vite të shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

Me datë 12.09.2013 rreth orës 20:00, në ..., duke drejtuar automjetin e shokut të tij V.P., të markës “Porche” me ngjyrë të zezë, me targa ..., e që në automjet ishin dhe shokët e tyre G.I. dhe E.T., i pandehuri me anë të forcës mekanike, pra duke drejtuar automjetin ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, ashtu që ka bërë vozitje të rrezikshme gjatë gjirove të shëtitjes nëpër qytet duke vozitur me shpejtësi të madhe dhe kështu ka rrezikuar edhe pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion si këmbësorët ashtu edhe automjetet, ndërsa afër ish “Adriatikut” ku patrulla e policore BC-515 Sh.P. dhe Xh.T. pas informatës së marrë se automjeti i dyshuar ka bërë vozitje të rrezikshme nëpër qytet, kanë arrit që ta ndalin automjetin në fjalë dhe nga vozitësi të marrin librezën e qarkullimit dhe të njëjtin e udhëzojnë që të shkon në Stacion Policor para automjetit të policisë, i cili e përcillte me rrotativë, por i njëjti, tek udhëkryqi i hekurudhës pasi që jep shenjë të kthimit në rrugën “...” për në Stacion Policor nuk kthehet fare, por vazhdon rrugën me një shpejtësi të madhe drejtë varrezave të serbëve, në këtë rast njoftohen të gjitha njësitë policore si dhe njësia BC 515, fillon ndjekjen e automjetit me sinjalin e policëve të trafikut për tu ndalur, por i njëjti nuk ndalet dhe vazhdon rrugën për në drejtim të ... për tu kthyer në magjistrale për në ... duke i rrezikuar edhe policët e trafikut që i ishin vënë në ndjekje edhe ata që ishin në pikë kontrolli në fshatin ... si edhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ashtu që gjatë vozitjes së rrezikshme në tunel humbë kontrollin mbi automjet dhe godet mbrojtëset e rrugës herë në njërin anë herë në tjetrën dhe me të kaluar tunelin nga shpejtësia e madhe drejtuesi humbë kontrollin mbi automjetin dhe i njëjti përplasat në shkallët e ndërtesës-shtëpisë në rr...” me ç ‘rast automjeti dëmtohet me pasagjerët që ishin në automjet, ku i pandehuri me të dëmtuarit arrijnë të largohen nga vendi ngjarjes në drejtim të panjohur.

Me këtë ka kryer veprën penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KPRK.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në afat prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Palët e dëmtuara, Sh.P. dhe Xh.T., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.479/2016 të datës 28.06.2018, kundër të pandehurit G.B. nga ..., për shkak te veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KPRK.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke deklaruar se e ndjej veten fajtor për veprën penale, kam qenë i ri dhe kam pas sjellje që kanë rënë ndesh me ligjin, si dhe ka shprehur keqardhje duke e lutur gjykatën që të ketë parasysh gjendjen ekonomike dhe personale pasi që është mbajtës i familjes dhe gjithë familja varen nga të ardhurat që i realizon. Për atë që ka ndodhur dhe ka premtuar se në të ardhmen do ta shtoj kujdesin në komunikacion.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe këtë ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë te cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti i oficerit i datës 12.03.2013; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici e datës 13.09.2013; Deklarata e dëshmitarit V.P. e dhënë në polici e datës 12.09.2013; Deklarata e dëshmitarit E.H. dhënë në polici e datës 13.09.2013; dhe,. fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe

pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 365 par.1 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris sjellje të tilla, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, rrethanat personale të kryerësit, sidomos gjendjen ekonomike të të pandehurit, i cili rezultoi i gjendjes së varfër ekonomike si dhe faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale, që është viti 2013 e deri tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë.

Ndërsa, si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, pasi që i akuzuari këtë veprë e ka kryer me dashje dhe fakti se duke bërë lëvizje me makinë, për një periudhë relativisht të gjatë dhe të rrezikshme, i njëjti ka treguar këmbëngulësi në kryerjen e kësaj veprë penale. Po ashtu si rrethanë rëndues është edhe intensitetin i rrezikut apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo veprë penale ka qellim të mbrojtë integritetin e individit, dhe në rastin konkret ky rrezikim është bërë ndaj jetës së individit, duke i rrezikuar jetën e disa individëve.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burgim të kushtëzuar, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.512/2018, dt.15.04.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.